

**AKT THEMELIMI
PËR KRIJIMIN SI PERSON JURIDIK TË SHOQËRISË
STUDIO LIGJORE "BAZAJ" SH.P.K**

Ky Akt-Themelimi u përpilua nga ortaku themelues:

Marjo Gjoni, biri i Bashkim dhe Elmira, lindur më datë 10.05.1998 në Tiranë dhe banues në Tiranë, mbajtës i Letërnjoftimit J80510058U, datë 13.02.2015, me profesion Avokat me Liç.12451 të lëshuar dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

I quajtur më poshtë ortaku themelues i cili në përputhje me Ligjin Nr.9901 të datës 14.04.2008 "Për Shoqëritë Tregtare" dhe të Ligjit Nr.9723 të datës 03.05.2007 "Për Qëndrën Kombëtare të Regjistrimit", si shoqëri tregtare me ndryshimet përkatëse ligjore apo nënligjore si dhe dispozitat e këtij Statuti, krijon një shoqëri me përgjegjësitë kufizuarsivjon:

I.FORMIMI

Ortaku themelues formon një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në përputhje me në përputhje me Ligjin Nr.9901 të datës 14.04.2008 "Për Shoqëritë Tregtare" dhe të Ligjit Nr.9723 të datës 03.05.2007 "Për Qëndrën Kombëtare të Regjistrimit", si shoqëri tregtare me ndryshimet përkatëse ligjore apo nënligjore

1.2.Emri i Shoqërisë

Emri i Shoqërisë do të jetë **STUDIO LIGJORE "BAZAJ",SH.P.K.**

1.3.Selia e Shoqërisë

Rruja,"Grigor Heba" ,Godina Nr.17,Kati III, Hyrja Nr.6, Njësia Administrative Nr.5, Bashkia Tiranë.

Shoqëria mund të themeloj filiale ,zyra përfaqësimi brenda dhe jashtë vendit në pajtim me legjislacionin në shqiptar në fuqi dhe ligjet ku aderon vendi ynë.

1.4.Kohëzgjatja e shoqërisë

Afati i veprimtarisë së shoqërisë i papërcaktuar.

Me vullnetin e ortakut të vetëm,kjo shoqëri mund të mbyllët edhe para afatit, në rastet kur kjo shoqëri humbet efektivitetin ekonomik.



1.5.Afati i veprimitarisë së shoqërisë

Afati i veprimitarisë është shoqërisë do të jetë pa afat.

Si ditë fillestare do të merret data e regjistrimit të saj në QKR.

1.6 Objekti i veprimitarisë

Veprimitaria e Shoqërisë do të ushtrohet në përputhje me Ligjin Nr.55/2018 "Për Profesionin e Avokatit në Republikën e Shqipërisë".

Shoqëria jep ndihmë juridike nëpërmjet :

- Ofrimin e cdo lloj konsulence tek personat fizike dhe juridike, vendas dhe te huaj, publike dhe/ose private si shoqerite tregtare, organizmat tregtare qeveritare, organizatat jo fitimprurese, fondacionet, institucionet shteterore, ministritë, departamentet qeveritare dhe autoritetet publike dhe ne vecanti konsulence ne lidhje me ceshtjet organizative, administrimin e biznesit, menaxhimin, marketingun, konsulence per taksat dhe tatimet si dhe planifikimin e per gjithshem te tyre, burimet njerezore dhe konsulence te per gjithshme per shoqerite qe veprojne ne sektoret e biznesit dhe te industrise, brenda kufizimeve te parashikuara ne ligj.
- Konsulence dhe ndërmjetsim për administrimin, shitblerjen, dhenien me qira te pasurive te luajtshme dhe te paluajtshme, te veprave civile, tregtare, industriale, publike apo private duke perfshire pa u kufizuar ne: ndermjetesim per kryerjen e vprimeve te mesiperme midis personave juridike privat apo publik, vendas apo te huaj dhe personave fizik, marketing, ekspertize shitje, menaxhim prone.
- Lidhjen apo përpilimin e kontratave të shitblerjeve, testamenteve, kontratave të porosisë, kontratave të sipërmarrjeve ,kontratave të qirasë, kontratave të përdorimit etj,të cilat më pas sipas vullnetit të palëve u nënshtronen ose jo vprimeve noteriale.
- Përpilimit të akteve proceduriale, kërkesë-padive, memove, kërkesave proceduriale penale , ankimeve, kundër ankimeve, kërkesave të thjeshta, të llojeve të ndryshme, rekurseve dhe kundër rekurseve etj për të gjitha shkallët e gjykimit në adresë të personave juridik, fizik, subjekteve të ndryshme shtetërore ose private etj.
- Pranisë së mbrojtjes apo përfaqësimit ligjor qoftë edhe në procese civile, administrative apo penale, për të gjitha subjektet e ligjit në të gjitha institucionet shqiptare,në administratën shtetërore, kompani private, gjykatat e të gjitha shkallëve të gjykimit, Gjykatën Kushtetuese apo atë të Strasburgut, organizatave fitimprurëse ose jo fitimprurëse, shoqata etj.
- Pranisë dhe përfaqësimit apo mbrojtjes së çështjeve familjare, bashkëpronësi bashkëshortore, financiare, detyrimesh kontraktore, pronësisë intelektuale, shuarjen apo lindjen e marrdhëniejës juridike, çështjet e pensionit, punës në administratën publike të të gjitha llojeve apo organeve më të larta dhe të të gjitha strukturave të shtetit shqiptar.
- Mbledhjen e provave për të cilat mendohet së ka shkelje ligjore apo për rastet e dyshimta dhe të kundraligjshme të cilat do të shërbejnë si një zinxhir i tërë që ndihmon në ecurinë e hetimit apo në zbardhjen e një ngjarje etj, ku ka dyshime për vepra penale të lehta ose të rënda të të gjitha llojeve.
- Ndërmjetësimi midis subjekteve të ndryshme për të gjitha llojet e shërbimeve etj.

II.KAPITALI

2.1 Kapitali

Kapitali themeltar i shoqërisë është 10.000 (dhjetë mijë) lekë, i ndarë në 1 kuotë të vetme me vlerë 10.000 lekë, kontribut i ortakut të vetëm themelues në masën 100%.

Asambleja e ortakëve (Ortaku i vetëm) ka të drejtë të bëjë shtesë të kapitalit themeltar të shoqërisë.

2.2 Fitimi

Fitimi i realizuar nga aktiviteti i shoqërisë i takon ortakut të vetëm themelues në masën 100 %

III.STRUKTURA JURIDIKE DHE ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

3.1 Organet e shoqërisë janë :

- Asambleja e ortakëve (ortaku i vetëm)
- Administratori i shoqërisë.
- Administratori i vetëm i shoqërisë do të jetë Marjo Bashkim Gjoni me një kohëzgjatje 5 (pesë) Vjecare.

IV.DISPOZITË E FUNDIT

4.1 Ndryshimet në këtë AKT mund të bëhen vetëm me shtesë dhe me shkrim të miratuar nga asambleja e ortakëve (Ortaku i vetëm).

Pjesë e pandarë e këtij akti është Statuti i shoqërisë i cili nënshkruhet rregullisht nga themeluesit e shoqërisë.

4.2 Ky akt themelimi u hartua në Tiranë në 4 kopje origjinale , i cili nënshkruhet rregullisht konform ligjës.

Tiranë më 14.02.2023

THEMELUESI

Marjo GJONI

